REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	01.06.2020
Referencë:	
Për:	z.Imri Ahmeti Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	Z Fauz Xhemajli – Nënkryetar i Komunës së Lipjanit Z, Lulzim Qerimi –Nënkryetar i Komunë së Lipjanit
Nga:	Elmaze Behluli – Drejtoreshë e DKA-së
Lënda:	Raport i punës për muajin maj , datë 01.05.2020 deri me 31.05.2020

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në të tri nivelet e shkollimit është mbajtur mësimi në distancë duke iu përmbajtë vendimit të MASHT-it për institucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, gjithashtu është mbajtë edhe komunikimi me MASHT-in , me drejtor e mësimdhënës.ndërsa punëtorët e drejtoratit kanë vazhduar punën në bazë të rekomandimeve të IKSHP dhe vendimeve të kryetarit të komunës me staf dhe orar të reduktuar

AKTIVITETET-

Dërgimi i raportit në MASHT-i, lidhur me mbarëvajtjen e mësimit online-distancë për shkollat fillore dhe të mesme nga Komuna Lipjan, (numri i nxënësve të përfshirë në mësim, numri i orëve të mbajtura, numri i mësimdhënësve të angazhuar, lëndët mësimorë të mbajtura).

- Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave në organizatën "Prishtina REA", për mësimdhënësit e lëndët së Tik-ut për pjesëmarrje në Projektin **"Përkrahje e BE për Konkurrueshmërinë e Sektorit Kosovar të TIK"**. Përmes këtij projekti do të trajnohen mësimdhënës dhe trajner të lëndës së Tik-ut nga Arsimi i mesëm professional, nga Komuna jonë mësimdhënësit e SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan.
- Përgatitja e të dhënave për mësimdhënësit e gjuhës angleze për **klasat: 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9**. Këto të dhëna janë kërkuar nga MASHT-i meqenëse është paraparë ndihmesë në implementimin e mësimit në distancë për mësimdhënësit e gjuhës angleze duke përdorur versionin elektronik të librave të gjuhës angleze që përdorin në shkollë.
- Pjesëmarrja në komisionin për përformancë komunale dhe plotësimi i formularëve
- Nxënësit e kalsës së 12 – maturantët kanë përfunduar mësimin me 20.05.2020
- MASHT- i janë dhënë udhzimet për plotësimin e ditarëve dhe shënimeve tjera që kërkohen nga kujdestarët e klasëve dhe gjithashtu kanë filluar dërgimin e planifikimeve e paraleleve dhe numrin e nxënësve për regjistrim në klasën e x-të për vitin shkollor 2020-2021

- Përgaditja dhe dërgimi e planifikimit për numrin e paralaeleve dhe numrin e nxënësve për regjistrim në klasën e pare për vitin shkollor 2020-2021, si dhe planifikimin për numrin e paraleleve dhe nxënësve për regjistrim në klasën e 10 -të
- Plotësimi i pytsorit nga disa shkolla fillore dhe nga DKA për OJQ – në "People in Need'' projekt i financuar nga Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut **(EIDHR)**
- Pregaditjet për mbajtjen e testit të aritshmërisë 2020 i cili do të mbahet me 23 qershor dhe testit të matures 2020 i cili do të mbahet me 4 korrik
- Nga MASHT kemi pranuar udhëzimet në detaje për mënyrën e mbajtjes së këtyre testeve duke ju përbmajtur edhe udhëzimeve të IKSHP –së duke respektuar distancë sociale .
- Gjithashtu nga shkollat kemi pranuar planifikimin për numrin e paraleleve dhe numrin e nxënësve për regjistrim në klasën e pare dhe në klasën e 10 për vitin shkollor 2020-2021 dhe i kemin dorzuar në MASHT.
- Takim me palë
- Pranim i kërkesave mga arhiva
- Lëshimi i vërtetimeve për vitet e 90-ta për mësimidhënës të pensionuar.
- Në kuadër të programit për efiqiencë në SHFMU "Zenel Hajdini" dhe SHFMU "Ernest Koliqi" ka filluar renovimi i këtyre shkollave

Qështjet finaciare dhe bugjetore (statistikat)

Eshtë bërë kërkesë zyrës së prokurimit për zhvillimin e procedurave për regullimin e infrastruktures shkollore për shtatë (7) shkolla fillore dhe një (1) të mesme:
Eshtë bërë kërkesë zyrës së prokurimit për zhvillimin e procedurave për furinizim për zyre në këto shkolla:
SHFMU"Haradin Bajrami" – Magurë
SHFMU "Drita" – Rubovc
Kërkesë për kontratë kornizë tri vjeqare për instalimin e internetit për 21 shkolla
Kërkesë për transportin e nxënësve për tri shkolla
Eshtë bërë kërkesë DPU-së për hartimin e projekteve kryesore për rnovimin tualeteve për këto shkolla: SHFMU "V.Frashëri" dhe pnf. Konjuh
SHFMU " H.Bajrami" deh pnf Vërshec
SHFMU "Kadri Beba"
SHFMU " Skenderbeu"
SHFMU Fehmi Agani"
SHFMU " Ibrahim Banushi" , SHML Gjimnazi " Ulpiana" Shkolla dhe mesme mikes "Shaqir Hoxha " - Shalë
Finalizimi i planifikimit të buxhetit

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Takimet: Kemi pasur numër më të vogël të takimev me palë për shkak të pandemisë por gjithsesi kemi mbajtur kontinuitetin e takimeve'për ti dëgjuar dhe shqyrtuar kërkesat për qështje të ndyshme takime me zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse pjesmarrja në komisione etj